



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 851/3 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

VENDIM
Nr. 67, datë 05.12.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 5, DATË 22.1.2024 DHE 46, DATË
26.7.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit 5, datë 22.1.2024, të Komisionerit, *“Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë”* dhe nr. 46, datë 26.7.2024, të Komisionerit, *“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë kryerjes së transferimit të nëpunëses Sonila Suta (Mehmeti) dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar situatën ligjore”*,

KONSTATOVA SE:

Me urdhrin nr. 74 (898 prot.), datë 02.10.2023, *“Për inspektimin e rasteve të emërimit dhe largimit të nëpunësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil”*, Komisioneri ka nisur kryesisht procesin e inspektimit, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet dhe largimet e nëpunësve në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në Bashkinë Kavajë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 5, datë 22.1.2024, të Komisionerit, *“Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë”*, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Gjithashtu, bazuar në informacionin e dërguar pranë Komisionerit nga punonjësja S. Suta me nr. 386, datë 14.06.2024, në përmbajtjen e të cilit janë ngritur pretendime për parregullsi të lejuara gjatë aplikimit të institutit të transferimit në shërbimin civil, në

momentin e transferimit të saj nga pozicioni *“Përgjegjës në Sektorin e të Ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore”*, pranë Bashkisë Kavajë, në pozicionin *“Specialiste e Tatim-Taksave”*, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ, bazuar në nenin 16, Kreu III *“Procedura paraprake”*, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 46, datë 26.7.2024, të Komisionerit, *“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë kryerjes së transferimit të nëpunëses Sonila Suta (Mehmeti) dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar situatën ligjore”*, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afateve të lëna në vendimet e mësipërme, me Urdhrin nr. 88, datë 13.10.2025, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 5, datë 22.1.2024 dhe vendimit nr. 46, datë 26.7.2024, në institucionin Bashkia Kavajë, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr.851/1, datë 13.10.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Kavajë me shkresën nr. 851 prot., datë 13.10.2025, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 5, datë 22.1.2024 dhe vendimit nr. 46, datë 26.7.2024, të Komisionerit”*. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimeve objekt i këtij verifikimi.

- ❖ Mbështetur në detyrat e lëna në **Vendimin nr. 5, datë 22.1.2024**, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kavajë, paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 1** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Kavajë të fillojë procesin e rivlerësimit për të përcaktuar me saktësi vendet e punës që do të trajtohen si pjesë e shërbimit civil, duke i paraprirë në këtë mënyrë procesit të miratimit të strukturës për vitin 2024 dhe procesit të hartimit dhe miratimit të planit vjetor të rekrutimit në shërbimin civil.

Gjatë verifikimit në subjekt, grupi i punës konstatoi se kjo pikë e vendimit nuk është zbatuar, fakt i cili u pasqyrua në procesverbalin e mbajtur në përfundim të procesit të verifikimit.

Nisur nga kompleksiteti i këtij procesi dhe vështirësia që ai paraqet gjatë zbatimit të tij në praktikë, njësia përgjegjëse e kësaj bashkie me shkresën nr. 4916 prot., datë 15.10.2025, *“Kërkesë për konfirmim të pozicioneve të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë”* ka kërkuar mendimin e Komisionerit në lidhje me pozicionet e përfshira në shërbimin civil.

Në **pikën 2** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me nëpunësit civilë përgjegjës të rishikojnë aktet ekzistuese dhe të hartojnë aktet e reja të përshkrimit të punës për pozicionet e punës që ende nuk janë hartuar, në koherencë me strukturën e institucionit; në përputhje me detyrat funksionale të tyre, duke zbatuar kërkesat specifike të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që e rregullojnë këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil që është vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.

Nga verifikimi në subjekt u konstatua se për këtë pikë nga ana e institucionit nuk është marrë asnjë masë.

Në **pikën 3** të dispozitivit të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e institucionit të hartohet dhe miratohet plani i rekrutimit brenda afateve ligjore, për vitin 2024 dhe të publikohet pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në lidhje me zbatimin e kësaj detyre, rezulton se me Urdhër nr. 116, datë 22.2.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit është miratuar plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil në Bashkinë Kavajë për vitin 2024, dërguar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit më shkresën nr. 1150/1 prot., datë 22.2.2024.

Njëkohësisht u administrua dhe u bë pjesë e dosjes së mbikëqyrjes në vazhdim edhe urdhri nr. 66, datë 4.3.2025, i Kryetarit të Bashkisë për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2025.

Në **pikën 4** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse, të vijnë me realizimin e procedurave të konkurrimit për të gjitha vendet vakante të shërbimit civil në kuptim të ligjit, ku përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, në përputhje me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit të Komisionerit, duke miratuar një planifikim të qartë të këtij procesi ku të përfshihet pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi. Ky plan veprimi duhej të dërgohej pranë Komisionerit 30 ditë pas marrjes dëgjimit për vendimin e paralajmërimit.

Nga analiza e dokumentacionit dhe verifikimeve të kryera në subjekt, konstatohet se plani i veprimit nuk është hartuar. Deri në momentin e verifikimit në subjekt ishin kryer vetëm 3 procedura konkurrimi, si më poshtë:

- Me aktin nr. 4557/9 prot., datë 31.10.2024, në përfundim të procedurës së konkurrimit F. Gjuzi është emëruar në pozicionin *“Drejtor”* Drejtoria e Burimeve Njerëzore;

- Me aktin nr. 2181/4 prot., datë 17.4.2024, në përfundim të procedurës së konkurrimit A. Xhiani është emëruar në pozicionin “*Specialist*” Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
- Me aktin nr. 2613/5 prot., datë 11.5.2025, në përfundim të procedurës së konkurrimit A. Çiçolli është emëruar në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”.

Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues, është kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Kavajë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, që aktualisht janë 123 raste, të evidentuara nominalisht në dispozitivin e vendimit.

Nga verifikimi në subjekt i kryer gjatë periudhës 4-7 nëntor 2025, rezultoi se njësia përgjegjëse ka ndërmarrë masa konkrete vetëm për një pjesë të rasteve, duke rivendosur gjendjen e ligjshmërisë dhe duke siguruar fillimin e procedurave të rekrutimit, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë institut.

Në kuadër të veprimeve të ndërmarra:

- Me aktin nr. 413, datë 4.11.2024, punonjësja Xh.Fusha është liruar nga pozicioni “*Specialist protokoll –Arkiv në NJA Golem*”;
- Me aktin nr. 334/1, datë 20.11.2024, punonjësi G.Xhiani është liruar nga pozicioni “*Përgjegjës*” në Sektorin e Zhvillimit të Territorit;
- Me urdhrin nr. 77, datë 31.1.2024, punonjësi A.Tabaku është liruar nga pozicioni “*Specialist IT për NjA*”;
- Me urdhrin nr. 841, datë 17.10.2023, punonjësja A.Dranga është liruar nga pozicioni “*Specialist*” në Sektorin e Zhvillimit të Territorit dhe Lejeve Zhvillimore;
- Me Urdhrin nr. 879, datë 15.11.2023, punonjësja F. Moçi është liruar nga pozicioni “*Specialist Koordinator vendor Kundër Dhunës në Familje*”;
- Me urdhrin nr. 850, datë 27.10.2023, punonjësi G. Lushka është liruar nga pozicioni “*Specialist IT*”;
- Me urdhrin nr. 664, datë 4.9.2023, punonjësja P. Mani është liruar nga pozicioni “*Përgjegjës*” në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Burimeve Ekonomike;
- Me urdhrin nr. 820, datë 5.10.2023, punonjësja M. Cara është liruar nga pozicioni “*Specialist në Emergjencat Civile*”;
- Me urdhrin nr. 22, datë 3.2.2025, punonjësi J. Haliaga është liruar nga pozicioni “*Specialist Inxhinier*”;
- Pë punonjësin E. Okshuni për të cilin në pikën 5 të këtij vendimi është kërkuar konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 657, është kthyer gjendja e ligjshmërisë pasi në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës është rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës. Konkretisht, me urdhrin nr.325/1, datë 27.8.2024, është emëruar në pozicionin “*Specialist Biznesi dhe të Ardhurave*”;
- Pozicioni i punës “*Specialist Agronom*” i mbajtur nga B. Shtini, nuk ekziston më në strukturën aktuale të Bashkisë Kavajë;

- Me urdhrin nr. 327, datë 1.10.2025, punonjësja F. Allajbej, e cila mbante pozicionin *“Specialist i Marrdhënieve me Publikun”*, është emëruar në një pozicion tjetër jashtë administrimit të shërbimit civil;
- Pozicioni *“Specialist Topograf”* i mbajtur nga punonjësja E. Kaja në strukturën aktuale është konsideruar si pozicion pune jashtë shërbimit civil, duke u emërtuar *“Topograf”*;
- Me aktin nr. 489, datë 17.8.2023, punonjësi A. Çurgu i cili mbante pozicionin *“Drejtor”* është emëruar në pozicion jashtë shërbimit civil;
- Me aktin nr. 241, datë 13.7.2023, punonjësja R. Kala është emëruar në pozicionin *“Drejtor”* në Drejtorinë e Çerdheve, pozicion jashtë shërbimit civil;
- Me aktin nr. 639, datë 31.8.2023, punonjësja M. Babaliu është emëruar në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Çështjeve Antikorrupsion”* pozicion jashtë shërbimit civil;
- Pozicioni *“Specialist Topograf NJA Luz i Vogël”* i mbajtur nga punonjësja E. Demrozi, në strukturën aktuale është konsideruar si pozicion pune jashtë shërbimit civil, duke u emërtuar *“Topograf”*;
- Me aktin nr. 296/1, datë 18.9.2025, punonjësja A.Sakja është emëruar në pozicionin *“Drejtor Kabineti”* pozicion jashtë shërbimit civil;
- Me aktin nr. 213/1, datë 16.10.2023, punonjësja Xh. Uzuni është emëruar në pozicionin *“Drejtor”* në Drejtorinë e Shërbimit Social pozicion jashtë shërbimit civil;
- Me aktin nr. 45, datë 24.1.2025, punonjësi A.Doka është emëruar në pozicionin *“Inspektor”* në Drejtorinë e Taksave, pozicion jashtë shërbimit civil;
- Me aktin nr. 131, datë 8.3.2024, punonjësja R. Çela është emëruar në pozicionin *“Arkëtare NJA Helmes”* pozicion jashtë shërbimit civil;
- Me aktin nr. 2613/5 prot., datë 11.5.2025, në përfundim të procedurës së konkurrimit A. Çiçolli është emëruar në pozicion *“Sekretar i Përgjithshëm”*;
- Me aktin nr. 4557/9 prot., datë 31.10.2024, në përfundim të procedurës së konkurrimit F. Gjuzi është emëruar në pozicion *“Drejtor”* Drejtoria e Burimeve Njerëzore;
- Me aktin nr. 2181/4 prot., datë 17.4.2024, në përfundim të procedurës së konkurrimit A. Xhiani është emëruar në pozicion *“Specialist”* Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Në përfundim të vlerësimit të kryer, rezulton se institucioni ka ndërmarrë veprime të plota për rivendosjen e ligjshmërisë vetëm në 24 nga 123 rastet e konstatuara si të paligjshme.

Në **pikën 6**, të dispozitivit të vendimit paralajmërues është kërkuar nga njësia përgjegjëse, të plotësojë dosjet e personelit, në bashkëpunim me njësinë e arkiv-protokollit, njësinë e financës, si edhe me vetë nëpunësit civilë të institucionit, me të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej ligjit, si në drejtim të mënyrës së rekrutimit, ashtu edhe të mënyrës së largimit apo lirimit nga shërbimi civil, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e administrimit të shërbimit civil dhe e zbatimit të ligjit nga ana e subjekteve të ngarkuara me këtë proces.

Në lidhje me këtë pikë të vendimit, nga këqyrja e dosjeve të personelit rezultoi se situata e paraqitur në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes vijonte të ishte e pandryshuar.

Në **pikën 7** të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar të evidentohen të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, për rikthimin në punë të nëpunësve civilë gjyqfitues, të cilat nuk janë ekzekutuar ende dhe të dokumentohet në një dosje të veçantë praktika që materializon veprimet e kryera për të zbatuar ato vendime gjyqësore.

Në lidhje me këtë pikë, njësia e burimeve njerëzore vendosi në dispozicionin të grupit të punës shkresën nr. 2200/1 prot., datë 14.7.2025, *“Dërgim informacioni në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil”*, me anë të të cilës është informuar Komisioneri për rikthimin në punë të nëpunësit E. Okshuni.

- ❖ Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 46, datë 26.7.2024, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga Kryetari i Bashkisë dhe njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kavajë, paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1 dhe 2 të dispozitivit të vendimit objekt i mbikëqyrjes në vazhdim Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Kavajë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 227, datë 15.08.2023, për emërimin e punonjësës S. Suta në pozicionin *“Specialiste tatim – taksave, Njësia Administrative Luz i Vogël”*, dhe të rregullojë pasojat që kanë ardhur në këtë rast. Pozicioni në fjalë të shpallet i lirë dhe të plotësohet në përputhje me ligjin.

Për sa i përket zbatimit të këtij kësaj detyre u konstatua se ende nuk është marrë asnjë veprim administrativ për të rikthyer gjendjen e ligjshmërisë në përputhje me rekomandimet e lëna në dispozitivin e këtij vendimi.

Në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, rezulton se Bashkia Kavajë ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmërues nr. 5, datë 22.01.2024, të Komisionerit, ndërsa për zbatimin e Vendimit nr. 46, datë 26.7.2024, nuk është marrë asnjë masë.

Sa i takon dy prej aspekteve më problematike që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, përfshi hartimin e përshkrimeve të punës, si dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin,

- duke qenë se këto nuk janë procese të lehta dhe kërkojnë një periudhë kohore të domosdoshme përtej afatit paralajmërues të përcaktuar nga Komisioneri,
- mbështetur në faktin se njësia përgjegjëse ka marrë disa masa, si hartimi i planit të rekrutimit, zhvillimi i disa procedurave të konkurrimit, apo masa të tjera për përfundimin e marrëdhënies me shërbimin civil të disa punonjësve të emëruar në kundërshtim me ligjin, si dhe

- nisur nga kërkesa e institucionit drejtuar Komisionerit ku kërkohet konfirmimi për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, që dëshmon se Bashkia Kavajë është në proces ristrukturimi,
- me synim plotësimin e tyre në përputhje të plotë me procedurat ligjore,

vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për strukturat e bashkive. Në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme ose tematike gjatë vitit 2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 5, datë 22.1.2024, të Komisionerit, *“Mbi paralajmërimin e institucionit, për zbatimin e ligjit gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kavajë”* dhe nr. 46, datë 26.7.2024, të Komisionerit, *“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë kryerjes së transferimit të nëpunëses Sonila Suta (Mehmeti) dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar situatën ligjore”*.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kavajë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha